# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-458099**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Zënë mbi 30 vende parkimi, problemi vazhdon dhe pse jemi ankuar te Policia Bashkiake" |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392755.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 15:17:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 19 shtator 2026, 15:02:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 19 shtator 2026, 15:01:00 UTC → 19 shtator 2026, 15:03:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9b2b383bdbce73236bf0675714ed3a743fc70cebd821a4b399ef338318906e27` |
| TEKSTI | `1b9198ac4a13533c88537dd03fa9d3f3f2c7277cb6019686b94e81b6058de507` |
| PAMJA | `2753313ae875bfa0d3397f0e1840a0bf4c4bc8b24a3f7179a612cb86240c33b9` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6d97d67bb7eb6436ad82dd9b51ae1c0fb3884629d815e13fc0bc888e1bd6fe87` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c772b20bb2a9907638c08fb1d7825d304059f9fa1ba842ea47b37301891e0c1b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6d97d67bb7eb6436ad82dd9b51ae1c0fb3884629d815e13fc0bc888e1bd6fe87`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Zënë mbi 30 vende parkimi, problemi vazhdon dhe pse jemi ankuar te Policia Bashkiake”

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 19.09.2026, 17:02

Share Share



Një qytetar i është drejtuar redaksisë së JOQ Albania për të denoncuar një problem që, sipas tij, vijon prej kohësh në zonën pranë Stadiumit “Dinamo”.

Qytetari pretendon se një biznes që më parë, sipas tij, operonte me emrin “Piemonte”, ndërsa aktualisht njihet si “Alfantino”, përdor në mënyrë të padrejtë një numër të konsiderueshëm hapësirash publike parkimi. Ai thotë se bëhet fjalë për më shumë se 30 vende dhe se hapësirat zihen me motorë dhe mjete të tjera, duke ua bërë të vështirë qytetarëve gjetjen e një vendparkimi.

Sipas tij, shqetësimi i është përcjellë disa herë Policisë Bashkiake përmes emaileve dhe mesazheve, por problemi nuk është zgjidhur.

Në një përgjigje të datës 12 maj 2026, Policia Bashkiake i ka bërë me dije qytetarit se ka kryer verifikime dhe kontrolle në terren në zonën pranë Stadiumit “Dinamo”. Sipas institucionit, gjatë kontrolleve janë konstatuar mjete të parkuara në kundërshtim me rregullat dhe për to janë marrë masa administrative.

Megjithatë, qytetari pretendon se situata vazhdon dhe kërkon që kontrollet të mos mbeten vetëm në masa sporadike, por të gjendet një zgjidhje përfundimtare për përdorimin e hapësirave publike.

Ai propozon që, nëse vendet e parkimit janë me pagesë, ato të përcaktohen qartë si të tilla dhe të shmanget çdo mundësi që hapësirat publike të shfrytëzohen në mënyrë të padrejtë nga individë apo biznese.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

## Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.